

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR nr. 945/2012

P. Nr. 164/2008


Data: 5 maj 2014

Gjykata e Apelit e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Philip Kanning (kryetar i kolegjit dhe gjyqtar referent) dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Abdullah Ahmeti dhe Fillim Skoro, si anëtarë të kolegjit, si dhe zyrtarja ligjore e EULEX-it, Natalie Dawson, si procesmbajtëse, në lëndën penale numër P. Nr. 164/2008 para Gjykatës Themelore të Prishtinës, lidhur me këta të pandehur dhe aktgjykimet përkatëse:

1. **J. N.**
[Redacted]
[Redacted]
[Redacted]
 - a. Nxitje e falsifikimit të dokumenteve zyrtare, në shkelje të Nenit 348(1), lidhur me Nenin 24, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (këtej e tutje 'Kodi') – FAJTOR
 - b. Mashtrim i rëndë në detyrë, në shkelje të Nenit 341(3) të Kodit – LIRUAR NGA AKUZA
2. **A. A.**
[Redacted]
[Redacted]
[Redacted]
 - a. Nxitje e falsifikimit të dokumenteve zyrtare, në shkelje të Nenit 348(1), lidhur me Nenin 24, të Kodit – FAJTOR
 - b. Shpërdorim i pozitës zyrtare, në shkelje të Nenit 339(3), lidhur me (1), të Kodit – FAJTOR
3. **S. S.**
[Redacted]
[Redacted]
[Redacted]
 - a. Shpërdorim i pozitës zyrtare, në shkelje të Nenit 339(3), lidhur me (1), të Kodit – FAJTORE

Duke vendosur lidhur me ankesat e:

- Mbrojtësit R. G. në emër të të pandehurit J. N. më 9 gusht 2011
- Mbrojtësit A. A. në emër të të pandehurit A. A. më 10 gusht 2011



Kundër aktgjykimit të trupit gjykues në këtë lëndë në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në lëndën P. Nr. 164/2008 më 11 nëntor 2010;

Duke marrë parasysh përgjigjet e Prokurores së apelit ndaj të dyja ankesave;

Pasi u këshillua dhe votoi më 5 maj 2014;

Duke vepruar sipas Neneve 423 dhe 424 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (këtej e tutje 'KPPPK');

Shqipton këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e mbrojtësit R. G. në emër të të pandehurit J. N. pranohet.
2. Aktgjykimi i trupit gjykues anulohet në lidhje me J. N.
3. Aktakuza rrëzohet në lidhje me J. N.
4. Ankesa e mbrojtësit A. A. në emër të të pandehurit A. A. pranohet pjesërisht dhe hidhet poshtë si e pabazuar pjesërisht.
5. Aktgjykimi i trupit gjykues anulohet në lidhje me A. A. lidhur me veprën penale të nxitjes së falsifikimit të dokumenteve zyrtare, në shkelje të Nenit 348(1), lidhur me Nenin 24, të Kodit vetëm.
6. Aktakuza rrëzohet në lidhje me A. A. lidhur me veprën penale të nxitjes së falsifikimit të dokumente zyrtare, në shkelje të Nenit 348(1), lidhur me Nenin 24, të Kodit vetëm.
7. Aktgjykimi i trupit gjykues konfirmohet në lidhje me A. A. dhe veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare, në shkelje të Nenit 339(3), lidhur me (1), të Kodit.

ARSYETIM

1. Ecuria procedurale dhe aktgjykimi i kundërshtuar

- a. Më 28 shkurt 2008, Prokurori Publik ushtroi aktakuzën PPS 480-5/2007 kundër S [REDACTED] S [REDACTED], J [REDACTED] N [REDACTED] dhe A [REDACTED] A [REDACTED] në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës.
- b. Më 14 shtator 2009 filloi shqyrtimi kryesor.
- c. Më 11 nëntor 2010, trupi gjykues shqiptoi aktgjykimin e tij.
- d. Dënimet e caktuara lidhur me secilin të pandehur ishin:
 - S [REDACTED] S [REDACTED] – një (1) vit burgim, me kusht për katër (4) vjet nëse nuk kryhet asnjë vepër tjetër;
 - J [REDACTED] N [REDACTED] – tre (3) muaj burgim, me kusht për një (1) vit nëse nuk kryhet asnjë vepër tjetër;
 - A [REDACTED] A [REDACTED] – dy (2) vjet burgim, me kusht për katër (4) vjet nëse nuk kryhet asnjë vepër tjetër;
- e. Më 9 gusht 2011, J [REDACTED] N [REDACTED] ushtroi ankesë.
- f. Më 10 gusht 2011, A [REDACTED] A [REDACTED] ushtroi ankesë.
- g. Më 23 tetor 2012, Prokurori i Shtetit paraqiti mendimin e tij.
- h. S [REDACTED] S [REDACTED] nuk ka ushtruar ankesë.

2. Parashtrësit e palëve

Parashtrësit me shkrim të mbrojtjes:

- a. Ka pasur shkelje esenciale të KPPK-së;
- b. Ka pasur shkelje esenciale të ligjit penal;
- c. Ka pasur vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Trupi gjykues nuk e vlerësoi si duhet peshën e besueshmërisë së dëshmitarëve.
- d. A [REDACTED] A [REDACTED] kundërshtoi edhe dënimin e caktuar nga gjykata.
- e. Aktgjykimi duhet të anulohet dhe t'i kthehet Gjykatës Themelore për rishqyrtim, ose të pandehurit duhet të lirohen nga akuzat nga Gjykata e Apelit.

Parashtrësit me shkrim të Prokurorit:

- a. Nuk ka pasur shkelje esenciale të KPPK-së, as të ligjit penal.
- b. Prokurori është i një mendimi me gjetjet e trupit gjykues lidhur me faktet dhe dënimet.
- c. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut duhet të lihet në fuqi.

Parashtrësit me gojë:

- a. Prokurori dhe mbrojtësit pajtohen se afati i parashkrimit (ndalimi absolut), në bazë të neneve 90(1)(5) dhe 91(6) të Kodit është arritur në lidhje me veprën penale të nxitjes së falsifikimit të dokumenteve zyrtare, në shkelje të Nenit 348(1), lidhur me Nenin 24, të Kodit.
- b. Prandaj të gjitha palët parashtrojnë se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut duhet të anulohet dhe aktakuza të rrëzohet në lidhje me këtë vepër.
- c. A [REDACTED] A [REDACTED] parashtron nga ana e tij se nuk ka kryer ndonjë vepër penale, sepse ai nuk ishte në pozitën për të dhënë urdhra.

3. Gjetjet e kolegjit


1. Ankesat janë të pranueshme dhe të paraqitura në afat.
2. J. N. nuk mori pjesë në seancën e sotme dhe asnjë shpjegim nuk iu dha gjykatës për mungesën e tij. Kolegji arriti në përfundimin se dorëzimi i thirrjes tek z. N. ishte bërë në afat. Në pajtim me Nenin 410(4) të KPPK-së, kolegji mori vendim për të vazhduar procedurën. Z. G. nuk kundërshtoi në emër të z. N.

Periudha e parashkrimit

3. Kolegji vlerësoi parashtrësit e të gjitha palëve në lidhje me veprën penale të nxitjes së falsifikimit të dokumenteve zyrtare, në shkelje të Nenit 348(1), lidhur me Nenin 24, të Kodit.
4. Në bazë të Nenit 90(1)(5) të Kodit Penal, afati i parashkrimit për një vepër të kësaj natyre është tre (3) vjet, pas së cilës periudhë procedura penale nuk mund të fillojë. Në bazë të Nenit 91(6), ndalimi absolut lidhur me ndjekjen penale është gjashtë (6) vjet, dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.
5. Duke qenë kështu, ndalimi absolut mbi procedurën penale u arrit në vitin 2011.
6. Ankesat u paraqitën brenda afatit të parashkrimit, por lënda doli para trupit gjykues të Gjykatës së Apelit vetëm pasi kishte kaluar ajo datë.
7. Në pajtim me Kodin, procedura në lidhje me veprën penale të nxitjes së falsifikimit të dokumenteve zyrtare pushohet.
8. Prandaj aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut duhet të anulohet, dhe aktakuza të rrëzohet në lidhje me J. N. dhe A. A. në lidhje me veprën e nxitjes së falsifikimit të dokumenteve zyrtare.
9. Në lidhje me J. N. ai nuk u dënua për ndonjë vepër tjetër, prandaj të gjitha çështjet kundër tij pushojnë.
10. Në lidhje me A. A. vepra penale e shpërdorimit të pozitës zyrtare mbetet për t'u shqyrtuar.
11. Kolegji mori parasysh Nenin 419 të KPPK-së në lidhje me të bashkë-pandehurën S. S. S. nuk u akuzua, as u dënua për veprën që ka arritur afatin e parashkrimit dhe ndalimin absolut në lidhje me të bashkë-pandehurin e saj (nxitja e falsifikimit të dokumenteve zyrtare). Prandaj asnjë ndryshim nuk kërkohet t'i bëhet aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut për sa i përket S. S.

A. A. – Vepra penale e shpërdorimit të pozitës zyrtare

12. Nga aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është e qartë se trupi gjykues e gjeti dëshminë e dëshmitarit B. L. të besueshme dhe i dha shumë peshë asaj.
13. Kolegji vlerësoi dëshminë e z. me hollësi dhe pajtohet me gjetjet e trupit gjykues. Dëshmia e z. ishte koherente, e besueshme dhe bindëse.
14. Kolegji dëgjoi parashtrësit e z. se rrethanat politike që kanë të bëjnë me kryerjen e veprës ndikonin dhe ishin përgjegjëse. Kolegji arrin në përfundimin se trysnitë politike në kohën materiale janë jo relevante në kryerjen e kësaj vepre konkrete lidhur me faktet e veçanta të saj.
15. Kolegji gjen se provat para trupit gjykues mbështesin aktgjykimin dënuës.
16. Prandaj kolegji lë në fuqi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në lidhje me veprën e shpërdorimit të pozitës zyrtare.



17. Dënimin e caktuar ndaj z. ^{A.} nga trupi gjykues, Kolegji e gjen tërësisht të duhur dhe të arsyetuar, duke marrë parasysh rrethanat dhe kohën e kaluar në paraburgim gjatë zhvillimit të procedurës.

Përpiluar në anglishte, gjuhë e autorizuar. Aktvendimi u arsyetua dhe u nënshkrua më 6 maj 2014.

Proces-mbajtëse

Kryetari i kolegjit

Natalie Dawson

Philip Kanning


Zyrtare ligjore e EULEX-it

Gjyqtar i EULEX-it

Anëtarë të kolegjit:

Abdullah Ahmeti

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit



Fillim Skoro

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit

GJYKATA E APELIT

PAKR nr. 945/2012

P. Nr. 164/2008

5 maj 2014